



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KP.nr. 99/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen juridike të Paditësit “N...i” Sh.p.k me seli në Prizren, me pronarë B.A. , me NUI ....., rruga “...” nr. ... Prizren, kundër të paditurit “I...” Sh.p.k, të cilën e përfaqëson drejtori Nj.Z. , rruga “ ...” p.n Prizren, me objekt kontesti vërtetimin e pronësisë dhe dorëzim, jashtë seance me datën 07.10.2022 merr këtë :

A K T V E N D I M

Konsiderohet e tërhequr padia e paditësit “N...” Sh.p.k me seli në Prizren, me pronarë B.A. , me NUI .... e ushtruar më datën 09.11.2020 kundër të paditurit “I...” Sh.p.k, të cilën e përfaqëson drejtori Nj.Z. me seli në Prizren, me të cilën ka kërkuar vërtetimin e pronësisë dhe dorëzim.

A r s y e t i m

Paditësi më datën 09.11.2020 në Gjykatën Themelore në Prizren ka ushtruar padi për vërtetimin e pronësisë dhe dorëzim, kundër “I...” Sh.p.k, të cilën e përfaqëson drejtori Nj.Z. me seli në Prizren, me të cilën ka kërkuar vërtetimin e pronësisë dhe dorëzim.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të padisë ka vërejtur se paditësi gjatë deponimit të padisë në gjykatë nuk ka bërë pagesën e taksës gjyqësor prandaj gjykata përmes vërejtjes për pagimin e taksës gjyqësore të datës 29.08.2022 e ka ftuar paditësin që na afat prej 15 dite të paguaj taksën

gjqësore në shumë prej 20,00 € dh, duke e paralajmëruar edhe me pasojat ligjore në kuptim të nenit 253 të LPK-së

Në shkresat e lëndës ekziston prova-fletë kthesa se paditësi me datë 09.09.2022 e ka pranuar vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore të kësaj gjykate KP.nr.99/22 datës 29.08.2022 me të cilin është ftuar për pagimin e taksës gjyqësore, duke u paralajmëruar për pasojat ligjore, ndërsa deri në ditën e marrjes së këtij Aktvendimi i njëjti nuk e ka paguar taksën Gjyqësore.

Duke marr parasysh faktin se as pas vërejtjes për pagim të taksës gjyqësore të dërguar nga gjykata, Paditësi nuk e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore për padinë e parashtruar dhe nuk ekzistojnë kushtet për lirim nga detyrimi i pagimit të njëjtës, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, duke u bazuar në nenin 253 par. 5 të Ligjit të Procedurës Kontestimore Nr. 03/L-006 (LPK) ku është përcaktuar se *“në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.”*

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti i Përgjithshëm

KP.nr.99/22, datë 07.10.2022

Gjyqtari  
Gent Bekeri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.